

Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime

Këshilli i Lartë Gjyqësor organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhje plenare ose në komisione. Këshilli mbledhet sa herë është e nevojshme, por jo më pak se 1 herë në muaj. Në mbledhjen plenare marrin pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit dhe drejtohet nga kryetari i tij. Në çdo rast, kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor është kur në to marrin pjesë jo më pak se 7 anëtarë.

Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur.

Mbledhja plenare merr vendime mbi:

- emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë dhe transferimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
- vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
- propozimin Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- miratimin e rregullave të etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
- drejtimin dhe kujdesjen për veprimtarinë në administratën e gjykatave;
- propozimin dhe administrimin e buxhetit të tij dhe atë të gjykatave;
- informimin e publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor;
- miratimin e akteve nënligjore normative, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me ndikim të përgjithshëm detyrues për të gjithë gjyqtarët, administratën gjyqësore, personat privatë dhe organet publike;
- miratimin e akteve për rregullimin e procedurave të brendshme të Këshillit;
- miratimin e Kodit të Etikës së Këshillit;
- shqyrtimin, sipas rastit, të vendimeve të komisioneve;
- miratimin e udhëzime jodetyruese;
- miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e administratës së Këshillit;
- miratimin e përbërjes të komisioneve të përhershme, të komisioneve të përkohshme, si dhe rregullave të detajuara për funksionimin e tyre.

Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrjnë veprimtarinë dhe marrin vendime në përputhje me fushën e kompetencave të tyre ose i propozojnë mbledhjes plenare të Këshillit miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të kësaj të fundit. Çdo Komision përbëhet nga tre anëtarë.

Komisionet e përhershme të Këshillit janë:

- Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit;
- Komisioni Disiplinor;
- Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale;
- Komisioni i Zhvillimit të Karrierës

Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të krijojë komisione të përkohshme për trajtimin e çështjeve të veçanta.

Në rastin e shqyrtimit nga komisioni dhe miratimit në mbledhjen plenare të akteve administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, njëri nga anëtarët e komisionit shërben si relator. Relatori caktohet me short, duke marrë parasysh ngarkesën dhe aftësitë e secilit anëtar sipas procedurës dhe rregullave më të hollësishme të miratuara nga Këshilli. Kryetari i Këshillit nuk mund të jetë relator.

Aktet e miratuara në mbledhjen plenare nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit, me përjashtim të akteve administrative individuale. Këto të fundit nënshkruhen nga çdo anëtar i pranishëm në mbledhje, siç është rënë dakord. Refuzimi i një anëtari për të nënshkruar përmbajtjen e vendimit nuk përbën shkak për pavlefshmërinë e aktit.

Ankimi i vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi gjyqtarët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese. Aktet administrative me efekt të përgjithshëm detyrues i nënshtrohen kontrollit të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, dhe kontrollit të Gjykatës Administrative të Apelit, në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me ligjin.